

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË MAMURRAS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Mamurras**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 1.01.2013 deri më datë 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr.60, datë 30.04.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1205/7, datë 30.04.2015, i ka rekomanduar z. Ilir Pjetri, Kryetar i Bashkisë Mamurras, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), nuk janë përcaktuar si duhet Objektivat, Misioni dhe Vizioni i Bashkisë Mamurras dhe nuk informohen si duhet menaxherët dhe punonjësit e njësisë publike në lidhje me përmbajtjen e deklaratës së misionit, objektiveve dhe të strategjisë, nuk është hartuar dhe miratuar Kod Etik për Institucionin dhe strukturat në veçanti, në përputhje me nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Mjedisi i kontrollit”, ka mangësi dokumentacioni lidhur me pasqyrimin e këtij komponenti të MFK. Strategjia e risqeve nuk është miratuar dhe nuk është identifikuar risku sipas nenit 21 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Nuk është bashkëpunuar me menaxherët e tjerë të institucionit për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektiveve dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ato drejtojnë, nuk janë marrë masa trajnuese për njohjen e këtij ligji dhe vënien në zbatim të tij, kjo edhe për faktin e mosnjohjes së këtij ligji nga një pjesë dërmuese e administratës së Bashkisë Mamurras

1.1 Rekomandim: Bashkia Mamurras të marrë masa për ngritjen Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), të përcaktojë objektivat, misionin dhe vizionin e Bashkisë, si dhe të hartojë dhe miratojë Kodin Etik, të identifikojë risku, të krijohet regjistri i riskut, të bëhet vlerësimi dhe kontrolli i tij , duke marra masa nëpërmjet trajnimeve për njohjen e ligjit për MFK si dhe për vënien në zbatim të tij.

Brenda muajit Korrik 2015

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit përkatës për secilin vit rezulton se për vitin 2013-2014, ***buxhetet janë miratuar jashtë afatit ligjor***, në kundërshtim me *ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, neni 32 .

2.1 Rekomandim: Bashkia Mamurras të marrë masa lidhur me miratimin e buxheteve vendore, duke zbatuar me korrektesë afatet ligjore të përcaktuara.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në llogarinë 32 “ *Objekte Inventari* ” Në këtë llogari rezulton të jenë përfshirë sendet, orenditë dhe materialet e ndryshme në pronësi të subjektit. Gjithsesi prej evidencave të pasqyruara rezulton se në këtë inventar bëjnë pjesë edhe materiale të cilat janë me vlerë mbi 10,000 lekë pra në këtë inventar rezulton se shuma prej 3,532,731 lekë duhet të inventarizohet dhe kontabilizohet në llogarinë 218. Veprim i cili është në kundërshtim me nenin 29, kap. III “Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” e UMF Nr. 30 Datë 27.12.2011 “ Për menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

3.1 Rekomandimi:Drejtoria e Financës të bëjë rregullimet dhe rakordimet e nevojshme, lidhur me Llogarinë 32 “ *Objekte Inventari*”, duke përfshirë vlerat në aktivet materiale afatshkurtra (me afat përdorimi nën një vit dhe me vlerë më të vogël se 10,000 lekë për çdo artikull) .

Brenda muajit Korrik 2015

4. Gjetje nga auditimi: Në veprimet e kryera nëpërmjet Bankës rezultoi se janë kryer shpenzime kancelarie gjithsej 4 raste në vlerën 415,612 lekë duke tejkaluar limitin e lejuar 400,000 lekë. Fakt i cili bie në kundërshtim me pikën 4 të Udhëzimit Nr. 2, datë 28.03.2013 “ Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar me udhëzimin Nr. 5, datë 16.7.2013 dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 28.02.2014 i cili shprehimisht sqaron se:

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të mos tejkalojë limitin e lejuar, për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, sipas Udhëzimeve përkatëse së bashku me ndryshimet e legjislacionit të prokurimeve të vitit 2015.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Lidhur me fazën e përgatitjes së paketës së dokumenteve dhe parashikimit të fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut, u konstatua se në 3 raste prokurime me procedurë të hapur, preventivat e hartuara përmbajnë shumë zëra punimesh ku çmimet nuk gjenden në manualin e miratuar me VKM nr. 407, datë 27.06.2012. Për këto raste mungojnë analizat e kostove të punëve publike, që do të prokurohen (të cilat nuk janë të parashikuara në manualin zyrtar) dhe nuk është bërë dokumentimi i këtyre analizave, pra ka mos argumentim të fondit limit, veprime dhe mosveprime këto, që janë në kundërshtim me nenin 28, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe me VKM nr 1, datë 10.01.2007, të ndryshuar, Kreu II, pika 2/ç .

5.1 Rekomandimi: Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor, konkretisht punonjësit e ngarkuar me llogaritjen e vlerës së kontratës dhe fondit limit, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, të analizojnë kostot e punëve publike, mallrave dhe shërbimeve, që do të *prokurohen (ku punët publike nuk janë të parashikuara në manualin zyrtar)*, duke krahasuar elementet e mësipërme dhe specifikimet teknike të punëve publike, në çdo rast të bëhet dokumentimi i të gjithë analizave, bazuar në dokumente vërtetuese dhe justifikuese, sipas rastit konkret të prokurimit.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Lidhur me fazën e përgatitjes së paketës së dokumenteve dhe parashikimit të fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut, u konstatua se në 2 raste të kryerjes së prokurimeve me procedurë të hapur, me objekt “Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit, dekorit, mirëmbajtjes së varrezave dhe shërbimit funeral të qytetit Mamurras”, në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit, të mbajtur nga komisioni, në preventiv dhe në analizat, nuk thuhet gjë për burimin dhe praktikën tekniko-dokumentare prej nga janë përcaktuar sipërfaqet e qytetit, si rrugë dhe trotuare, lulishte, varreza etj., mbi bazën e të cilave janë hartuar analizat e çmimeve, në moszbatim të VKM nr 1, datë 10.01.2007, të ndryshuar, Kreu II, pika 2/ç ‘’.

6.1 Rekomandimi: Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor: Bashkia Mamurras (punonjësit e ngarkuar me llogaritjen e vlerës së kontratës dhe fondit limit), të marrin masa që analizat e kostove të punimeve, të jenë të bazuara në burime dhe praktika të sakta dhe ligjore tekniko-dokumentare, të nxjerra nga zyrat e institucionit ose jashtë tij dhe mbi bazën e të cilave duhen hartuar analizat e çmimeve

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Lidhur me fazën e përgatitjes së paketës së dokumenteve dhe parashikimit të fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut, u konstatua se në 2 raste prokurime me procedurë të hapur, projektet nuk janë konfirmuar dhe legalizuar nëpërmjet vulës zyrtarë të Bashkisë Mamurras dhe nuk janë bërë hyrje, ndërkohë që janë hartuar nga projektues me licencë të kontraktuar nga Bashkia Mamurras.

7.1 Rekomandimi: Në çdo rast, Njësia e prokurimit dhe punonjësit e ngarkuar me llogaritjen e vlerës së kontratës dhe fondit limit, të marrin masa dhe të konfirmojnë zyrtarisht Projektet e Zbatimit për rastet kur këto hartohen nga subjekte jashtë institucionit, të bëhen hyrje në magazinë dhe të vendosen në kartelat e punonjësve përgjegjës për arkivimin e dokumentacionit.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Lidhur me fazën e zhvillimit të tenderit, zbatimit të procedurave të prokurimit dhe nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në shpalljen e fituesit, u konstatua se në të gjitha rastet, nuk ka patur ndarje të detyrave ndërmjet anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, sipas kërkesave të kreu V, pika 1, germa “a”(VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

8.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të bëjë ndarjen e detyrave, ndërmjet anëtarëve të KVO-së, sipas detyrimit që përcakton VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me qëllim që të përgjegjësohet secili anëtar i KVO-së, për detyrat që ka dhe zbatimin e tyre.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Lidhur me fazën e lidhjes dhe zbatimit të kontratave, zbatimi i kërkesave ligjore e nënligjore për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, u konstatua se lidhur me prokurimin “Blerje karburanti”, nga auditimi i urdhër shpenzimeve për likuidimin e sasive të kontraktuara, bashkëlidhur këtyre urdhër-shpenzimeve, nuk ndodhet dokumentacioni për marrjen në dorëzim të karburantit, sasi, cilësi, specifikime teknike dhe mungojnë të dhënat e nxjerra nga faqja zyrtare e APP-së, lidhur me çmimet CIF , sipas Bursës Reuters (Plats), për muajt Prill, Maj, Qershor, Korrik, Nëntor të vitit 2013, mosveprime këto në kundërshtim me pikat 42-50, të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me kontratën e lidhur dhe specifikimet teknike .

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në çdo rast likuidimi të faturave të karburantit, t'u bashkëlidhet urdhër-shpenzimeve përkatëse, dokumentacioni për marrjen në dorëzim të karburantit, sasi, cilësi, specifikime teknike dhe të dhënat e nxjerra nga faqja zyrtare e APP-së lidhur me çmimet CIF , sipas Bursës Reuters (Plats).

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Lidhur me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, rezultoi se pasqyrat e paraqitura për planifikimin e buxhetit të viteve 2013- 2014 janë të njëjtit format pa një analizë të detajuar, nuk janë marrë të gjitha të dhënat dhe resurset e mundshme brenda dhe jashtë institucionit për një planifikim sa më real të të ardhurave vendore, nuk rezulton të ketë praktikë dokumentare për këtë qëllim nga këto burime .

10.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa që, në çdo rast dhe lloj taksash dhe tarifash vendore, vit pas viti, planifikimi i të ardhurave të bazohet mbi praktika të sakta dhe të bazuara dokumentare, të nxjerra nga brenda dhe jashtë institucionit, si nga ZVRPP, EKB, Zyra e Gjendjes Civile, ZMMT, etj.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Lidhur me tarifat e pastrimit dhe gjelbërimit, planifikimi është bërë pa u bazuar në të dhënat analitike të argumentuara dhe të vërtetuara me dokumente, nga Zyra së Gjendjes Civile (për numrin e familjeve), lidhur me subjektet të cilat kanë detyrimin për këto lloj tarifash, duke bërë kështu një planifikim të cunguar në shumën për vitet 2013-2014, 7,438 mijë lekë për tarifën e pastrimit dhe 3,085 mijë lekë për tarifën e gjelbërimit, duke ulur impenjimin e Zyrës përkatëse dhe punonjësve për vjeljen e tarifave përkatëse, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, me ndryshimet .

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë planifikimin për tarifat e pastrimit dhe gjelbërimit, bazuar në numrin e familjeve sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile, në periudhën e hartimit të projekt-planit të të ardhurave.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Lidhur me taksën për ndërtesat, planifikimi është bërë në mungesë të të dhënave të marra nga ZVRPP dhe EKB, mbi numrin e ndërtesave të ndara në zonat rurale dhe urbane, për ndërtesat për qëllim biznesi, me të dhënat për sipërfaqet e përgjithshme sipas llojeve të këtyre ndërtesave dhe bazuar në çmimet e caktuara për m², të nxirreshin saktësisht shifrat për një

planifikim të mirë, pra nuk ka një argumentim të saktë për këtë qëllim, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, me ndryshimet .

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në planifikimin e taksës së ndërtesës, të vlerësojë e marrë në konsideratë të dhënat e marra nga ZVRPP dhe EKB, mbi numrin e ndërtesave të ndara në zonat rurale dhe urbane, për ndërtesat për qëllim biznesi, me të dhënat për sipërfaqet e përgjithshme, të periudhës kur hartohet projekt-plani i të ardhurave.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Lidhur me debitorët, (27 subjekte debitorë në shumën 777 mijë/lekë në fund të vitit 2014) dhe subjektet të cilët kanë aplikuar pranë QKR-së për mbylljen e përkohshëm të aktivitetit, ku për vitet 2013-2014, na u vunë në dispozicion 48 njoftime të QKR-së. Mungojnë në dosje deklaratat me shkrim, për ndërprerje të përkohshme të aktivitetit, certifikatat e regjistrimit, deklarata mbi qarkullimin e realizuar dhe mandat arkëtimi për pagesën e detyrimit, deri në momentin e ndërprerjes të aktivitetit, pra konstatohet se nuk janë likuiduar detyrimet deri në këtë moment të ndërprerjes të aktivitetit. Veprime dhe mosveprime këto, në mospajtim me pikën 8, të Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme, 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”.

13.1 Rekomandimi: Bashkia Mamurras (Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore), të marrë masa, duke përcaktuar dhe nxjerrë me saktësi të gjithë subjektet, që kanë ndërprerë aktivitetin e nuk kanë likuiduar detyrimet, duke i klasifikuar si debitorë dhe duke rritur numrin e debitorëve, (ku aktualisht janë 27 subjekte debitorë në shumën 777 mijë/lekë), duke ndjekur administrativisht dhe gjyqësisht arkëtimin e vlerave, në të gjithë shkallët e sistemit gjyqësor, deri në likuidimin e tyre të plotë.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Mamurras nuk është kryer asnjë inventarizim kadastral pyjor, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës), shtrirë në territorin e juridiksionit të Bashkisë Mamurras. Mungon e nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrimi balancimit të fondit kullor, mosveprim ky në kundërshtim me nenin 5, pika 2 germa “b”, “Pronësia”, neni 7, “Inventarizimi”, neni 8, “Regjistrimi”, neni 9, “Regjistri i Fondit Kullor”, neni 14, “Planë e Mbarështimit” dhe neni 15, “Bimët Mjekësore”. ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullor”, Prej Bashkisë Mamurras nuk disponohet kontratë për dhënie me qira të tokës bujqësore, megjithëse sipas evidencës për ndarjen e tokës sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, janë 223 ha tokë bujqësore e pa ndarë dhe e pa regjistruar në emër të Bashkisë Mamurras, dhënë familjeve të përmbytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë, bazuar në VKM 306, datë 30.06.1994 dhe dërguar Bashkisë me shkresën nr. 1887/1. prot më datë 28.05.2002 dhe protokolluar prej Bashkisë Mamurras më datë 04.06.2002 me nr. 771. prot, gjithashtu për vitet 2013 dhe 2014, nuk evidentohet asnjë m³ dru, apo lëndë punimi a material drusor tjetër për përdorim a shitje për nevoja të komunitetit. Nuk evidentohen të ardhura të realizuara nga përdorimi i pyjeve, nuk është raportuar e nuk përfshihet me shifra një gjë e tillë. Gjithashtu, theksojmë se për vitet 2013 dhe 2014 nuk janë krijuar të ardhura nga tarifat e përdorimit të kullotave dhe kositje, nga kapaciteti i kullotave në juridiksionin e bashkisë Mamurras (*llogaritur sipas tarifave të VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje dhe Kositje”, sipas evidencës së inspektorit veteriner evidentohen 1324 krerë të imta x 100 lekë/krerë x 2 vjet = 264,800 lekë si njëthundrak 73 x 800lekë/krerë x 2 vjet = 116,800 lekë*). Si konkluzion nga mos hartimi i planit përkatës të menaxhimit, mos parashikimit për dhënie me qira, mos përfshirja në buxhetet përkatës të secilit prej viteve, si në pjesën e të ardhurave ashtu dhe në shpenzime, në rast realizimi do të sillnin zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave .

14.1 Rekomandim: Bashkia Mamurras të marrë masat për hartimin e planit të menaxhimit e mbarështimi në pyje, kullota e livadhe, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimësi të ndryshme, dhënien me qira të pronave të veta etj, si dhe krijimin e të ardhurave dytësore të cilat do të siguronin zhvillim të qëndrueshëm, burime të ardhurash dhe vënien në efikasitet të plotë të këtyre resurseve.

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, vitet 2013-2014 prej Bashkisë Mamurras janë evidentuar **13 raste**, për ndërtime në papajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, për të cilat INUV ka vendosur prishjen e tyre, vendime me gjoba si dhe ekzekutime vendimesh, duke bërë edhe njoftimin e subjekteve. Gjithsesi rezulton se prej INUV nuk janë marrë masat e duhura për ekzekutimin e 1 vendimi për prishjen e një objekti, si dhe nuk ka ndjekur në rrugë ligjore deri në kallëzim penal rastet e konstatuara .

15.1 Rekomandim: INUV-i të marrë masat e duhura për ekzekutimin e vendimit të prishjes së objektit, i mbetur pezull dhe të ndjekë në rrugë ligjore, deri në kallëzim penal rastet e konstatuara.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: -INUV nuk ka aplikuar procesverbal për konstatimin e kundërvajtjes për mjetet dhe makineritë; vendim për dënim me gjobë për mjetet dhe makineritë; procesverbal për sekuestrimin e mjeteve e të makinerive; vendim për sekuestrimin e mjeteve e të makinerive. Veprimi i mësipërm bie në kundërshtim me VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”, i ndryshuar, pika 20/1, germa c; germa “d” dhe germa “dh” .

16.1 Rekomandim : INUV-i të marrë masa për aplikimin e procesverbaleve, në rastet e kundërvajtjes dhe dënimit me gjobë për sekuestrimin e mjeteve dhe makinerive.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Emërimet e punonjësve në strukturën e INUV, në 2 raste bien në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, pasi K/Inspektor G.P rezulton me arsim të lartë në Akademinë Ushtarake, gjithashtu Inspektori A.M rezulton me arsim të mesëm të përgjithshëm, fakt i cili bie ndesh me nenin 11, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, i cili shprehet se “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe Inspektorëve të Inspektoratit Urbanistik Vendor”.

17.1 Rekomandim : Bashkia Mamurras të marrë masa e të rekrutoj, punonjës të INUV-it, ku kandidatët për Kryeinspektor, duhet të kenë marrë formimin e duhur dhe arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidro-gjeologjisë dhe mjedisit..

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Emërimi i punonjësve në strukturën e Policisë së Bashkisë Mamurras në 3 raste nuk është kryer në bazë të “Rregullores së brendshme TIP e policisë së Bashkisë dhe Komunës”, miratuar me urdhrin e përbashkët të dy ministrive, si Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit si dhe Ministria e Rendit Publik, Kreu III “Marrëdhëniet e Punës dhe Funksionet Organike, neni 11, pikave 1, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 “Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi”, pika 5. Si dhe në kundërshtim me nenin 7 ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të Bashkisë dhe të Komunës”.

18.1 Rekomandim: Bashkia Mamurras të marrë masa e të rekrutoj, punonjës të Policisë së Bashkisë, kandidatë që të kenë marrë formimin në Akademinë e Rendit Publik apo Akademinë e Policisë së Rendit dhe emërimi në detyrë të bëhet, duke respektuar kriteret e sipërpërmendura .

Menjëherë

19. Gjetje nga auditimi: Lidhur me zbatimin e urdhrave të Kryetarit të Bashkisë për konstatimet e dëmtimit të rrugëve, ndotje të ambientit si dhe ndërprerje e lidhje të paligjshme uji etj., janë mbajtur procesverbale të cilat në shumicën e rasteve në procesverbale nuk është referuar baza ligjore dhe nuk janë plotësuar fletë gjobe për shkeljet e konstatuara, në mbështetje me nenin 13 të

ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës”.

19.1 Rekomandim: Bashkia Mamurras të marrë masa që procesverbalet e policisë të protokollohen të gjitha dokumentet me referencat ligjore përkatëse, për shkeljet e konstatuara të plotësohen fletë gjoba.

Menjëherë.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bashkia Mamurras të marrë masa dhe të kryej kontabilizimin e detyrimeve, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim për shpërblimin e dëmit me **vlerën 7,995 lekë** në mënyrë analitike, si më poshtë:

1. Nga auditimi i likuidimit të karburantit për muajt Gusht, Shtator, Tetor, të vitit 2013 rezulton se, me Urdhër-Shpenzimin nr. 234, datë 17.09.2013 dhe faturat tatimore përkatëse, është likuiduar OE-së “M.RR” detyrimi kontraktor, bazuar në fletët përkatëse të përlllogaritjes së çmimit të karburantit. Marzhi i fitimit për të dy rastet është llogaritur 24 lekë, bashkë me TVSH dhe është mbledhur e mbi shumën e nxjerrë është llogaritur përsëri TVSH-ja. Kështu duhej llogaritur gjithsej 417,014 lekë dhe janë llogaritur 425,009 lekë detyrime sipas faturave, në mos zbatim të pikës 54, të UMF Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pra konstatohet pagesë e tepërt në favor të OE “M.RR” në *shumën 7,995 lekë*

1.1 Titullarit njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxjerrë aktet administrative me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit gjithsej në shumën **7,995 lekë**, nga Operatori Ekonomik “M.RR”, në të kundërt dëmi të likuidohet nga personat përgjegjës.

Deri më datë 30.06.2015

C. MASA DISIPLINORE

C.I. Mbështetur në nenin 58, germa a, b, c, ç, “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, **kërkojmë** Kryetarit të Bashkisë Mamurras, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga puna**” dhe për ata me kontratë, nga masa “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënieve të punës**”, për këta punonjës:

1. z. E.K me detyrë Drejtor i Financë-Buxhetit,

Për kontabilizim të gabuar të llogarisë 32 “*Objekte inventari*” për vitin 2013 kjo llogari rezulton të jetë 21,811,295 lekë me një ulje prej 500,785 lekë nga viti paraardhës 2012 e cila rezulton të jetë në vlerën 22,312,080 lekë. Në këtë llogari rezulton të jenë përfshirë sendet, orenditë dhe materialet e ndryshme në pronësi të subjektit. Gjithsesi prej evidencave të pasqyruara rezulton se në këtë inventar bëjnë pjesë edhe materiale të cilat janë me vlerë mbi 10,000 lekë pra në këtë inventar rezulton se shuma prej 3,532,731 lekë, veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 29, të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap III “Rregjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

-Për faktin se nga auditimi i likuidimit të karburantit për muajt Gusht, Shtator, Tetor të vitit 2013 është kryer me Urdhër-Shpenzimin nr. 234, datë 17.09.2013 dhe faturat tatimore përkatëse, i është likuiduar OE-së “M.RR” detyrimi kontraktor, bazuar në fletët përkatëse të përlllogaritjes së çmimit të karburantit. Marzhi i fitimit për të dy rastet është llogaritur 24 lekë, bashkë me TVSH dhe është mbledhur e mbi shumën e nxjerrë është llogaritur përsëri TVSH-ja. Në këto kushte,

duhej llogaritur gjithsej 417,014 lekë dhe janë llogaritur vlerë 425,009 lekë, detyrime sipas faturave, pra konstatohet pagesë e tepërt në favor të OE “M.RR” në shumën 7995 lekë.

2. znj. P.B, ne detyrë specialiste,

-Për kontabilizim të gabuar të llogarisë 32 “Objekte inventari” për vitin 2013 kjo llogari rezulton të jetë 21,811,295 lekë me një ulje prej 500,785 lekë nga viti paraardhës 2012 e cila rezulton të jetë në vlerën 22,312,080 lekë. Në këtë llogari rezulton të jenë përfshirë sendet, orenditë dhe materialet e ndryshme në pronësi të subjektit. Gjithsesi prej evidencave të pasqyruara rezulton se në këtë inventar bëjnë pjesë edhe materiale të cilat janë me vlerë mbi 10,000 lekë pra në këtë inventar rezulton se shuma prej 3,532,731 lekë, veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 29, të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap III “Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”,

3. znj. K I, me detyrë specialiste,

-Për kontabilizim të gabuar të llogarisë 32 “Objekte inventari” për vitin 2013 kjo llogari rezulton të jetë 21,811,295 lekë me një ulje prej 500,785 lekë nga viti paraardhës 2012 e cila rezulton të jetë në vlerën 22,312,080 lekë. Në këtë llogari rezulton të jenë përfshirë sendet, orenditë dhe materialet e ndryshme në pronësi të subjektit. Gjithsesi prej evidencave të pasqyruara rezulton se në këtë inventar bëjnë pjesë edhe materiale të cilat janë me vlerë mbi 10,000 lekë pra në këtë inventar rezulton se shuma prej 3,532,731 lekë, veprim i cili bie në kundërshtim me nenin 29, të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap III “Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, i cili shprehimisht sqaron se : “...Kufiri minimal për pragun e vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale është 10000 leke dhe afat përdorimi mbi një vit ...” .

4. z. E. Gj, inspektor i pyjeve

-Për faktin se nga Bashkia Mamurras rezultoi se për vitet 2013 dhe 2014 nuk evidentohet asnjë m³ dru, apo lëndë punimi a material drusor tjetër për përdorim a shitje për nevoja të komunitetit dhe nuk evidentohen të ardhura të realizuara nga përdorimi i pyjeve, nuk raportohet e nuk përfshihet me shifra një gjë e tillë.

Nuk është kryer asnjë inventarizim kadastral pyjor me synim evidencimin e përditësimit e fuqisë lëndore, fuqisë kullosore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës) shtrirë në territorin e juridiksionit të Bashkisë Mamurras.

Mungon evidentimi, administrimi balancimit të fondit kullosor, mosveprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për Fondin Kullosor”, neni 5, pika 2 germa “b”, “Pronësia”, neni 7, “Inventarizimi”, neni 8, “Regjistrimi”, neni 9, “Regjistri i Fondit Kullosor”, neni 14, “Planet e Mbarështimit” dhe neni 15, “Bimët Mjekësore”.

Bashkia Mamurras nuk dispononte kontrata për dhënie me qira të tokës bujqësore, megjithëse sipas evidencës për ndarjen e tokës sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, janë 223 ha tokë bujqësore e pa ndarë dhe e pa regjistruar në emër të Bashkisë Mamurras, dhënë familjeve të përmblytura nga ndërtimi i hidrocentraleve në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë bazuar në VKM 306, datë 30.06.1994 dhe dërguar kësaj Bashkie me shkresën nr. 1887/1. prot më datë 28.05.2002 dhe protokolluar prej Bashkisë Mamurras më datë 04.06.2002 me nr. 771. Prot.

5. z. G.P Kryeinspektor i INUV-it,

Për faktin se, për periudhën objekt auditimi, vitet 2013-2014 prej Bashkisë Mamurras janë evidentuar **13 raste**, për ndërtime në papajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, për të cilat INUV ka vendosur prishjen e tyre, vendime me gjoba si dhe ekzekutime vendimesh duke bërë edhe njoftimin e subjekteve. Gjithsesi rezulton se prej INUV nuk janë marrë masat e duhura për ekzekutimin e 1 vendimi për prishjen e një objekti si dhe nuk ka ndjekur në rrugë ligjore deri në kallëzim penal rastet e konstatuara.

-INUV nuk kishte aplikuar procesverbale për konstatimin e kundërvajtjeve për mjetet dhe makineritë; vendim për dënim me gjobë për mjetet dhe makineritë; procesverbal për sekuestrimin e mjeteve e të makinerive; vendim për sekuestrimin e mjeteve e të makinerive mosveprime këto

në kundërshtim me VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”, i ndryshuar, pika 20/1 germa c; germa d dhe germa dh.

Ka munguar bashkëveprimi dhe bashkërendimi i veprimeve inspektuese dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 81, të ligjit nr. 119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”.

-INUV nuk ka ushtruar kontrolle në objektet që ndërtohen në zbatim të kontratave publike për periudhën 2013 dhe 2014, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 81, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”.

6. z. A.M, Inspektor i INUV-it

7. z. P.Sh, Inspektor i INUV-it.

8.znj. B.M, Inspektore e INUV-it.

-Për faktin se, për periudhën objekt auditimi, vitet 2013-2014 prej Bashkisë Mamurras janë evidentuar **13 raste**, për ndërtime në papajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, për të cilat INUV ka vendosur prishjen e tyre, vendime me gjoba si dhe ekzekutime vendimesh duke bërë edhe njoftimin e subjekteve. Gjithsesi rezulton se prej INUV nuk janë marrë masat e duhura për ekzekutimin e 1 vendimi për prishjen e një objekti si dhe nuk ka ndjekur në rrugë ligjore deri në kallëzim penal rastet e konstatuara.

-INUV nuk kishte aplikuar procesverbale për konstatimin e kundërvajtjeve për mjetet dhe makineritë; vendim për dënim me gjobë për mjetet dhe makineritë; procesverbal për sekuestrimin e mjeteve e të makinerive; vendim për sekuestrimin e mjeteve e të makinerive mosveprime këto në kundërshtim me VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”, i ndryshuar, pika 20/1 germa c; germa d dhe germa dh.

Ka munguar bashkëveprimi dhe bashkërendimi i veprimeve inspektuese dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 81, të ligjit nr. 119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”.

-INUV nuk ka ushtruar kontrolle në objektet që ndërtohen në zbatim të kontratave publike për periudhën 2013 dhe 2014, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 81, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”.

9. Për znj. R.P, specialiste teknike,

Për faktet se:

a. Në **3 raste** prokurime me procedurë të hapur, preventivat e hartuara përmbajnë shumë zëra punimesh ku çmimet nuk gjenden në manualin e miratuar me VKM nr. 407, datë 27.06.2012, si dhe për këto raste mungojnë analizat e kostove të punëve publike, që do të prokurohen (të cilat nuk janë të parashikuara në manualin zyrtar), ku në këto raste nuk është bërë dokumentimi i këtyre analizave, pra ka mos argumentim të fondit limit. Veprime dhe mosveprime këto që janë në kundërshtim me nenin 28, Kreu II, pika 2/ç të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe me VKM nr 1, datë 10.01.2007, të ndryshuar.

b. Në 2 raste të kryerjes së prokurimeve me procedurë të hapur, me objekt “Shërbimi i pastrimit, gjelbërimit, dekorit, mirëmbajtjes së varrezave dhe shërbimit funeral të qytetit Mamurras”, në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit, të mbajtur nga komisioni, në preventiv dhe në analizat, nuk thuhet gjë për burimin dhe praktikën tekniko-dokumentare prej nga janë përcaktuar sipërfaqet e qytetit, si rrugë dhe trotuare, lulishte, varreza etj., mbi bazën e të cilave janë hartuar analizat e çmimeve, në moszbatim të Kreu II, pika 2/ç.VKM nr 1, datë 10.01.2007, të ndryshuar,

c. Në 2 raste prokurime me procedurë të hapur, projektet nuk janë konfirmuar dhe legalizuar nëpërmjet vulës zyrtarë të Bashkisë Mamurras dhe nuk janë bërë hyrje, ndërkohë që janë hartuar nga projektues me licencë të kontraktuar nga Bashkia Mamurras.

10. Për znj. P.B me detyrë specialiste e pagave

-Për kontabilizim të gabuar të llogarisë 32 “*Objekte inventari*” për vitin 2013 kjo llogari rezulton të jetë 21,811,295 lekë me një ulje prej 500,785 lekë nga viti paraardhës 2012 e cila rezulton të jetë në vlerën 22,312,080 lekë.

Nga Bashkia Mamaurras është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave, për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Rezart Golemaj, Abdulla Duka dhe Aleksander Papadhimitri, më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT